

MËSO RRETH ASAJ QË BËJNË MISIONARËT! MË PAS NDIQE SHTEGUN DHE BËJE SFIDËN.

SFIDA MISIONARE



Misionarët takojnë njerëz të rinj dhe flasin me ta.

Mendo rreth një talenti që ke. Më pas përdore atë talent për t'i shërbyer dikujt!



Mëso të thuash disa fjalë në një gjuhë të re. Mund të mësosh të thuash: "Jezusi më do" ose "Unë jam një fëmijë i Perëndisë".



Disa misionarë mësojnë një gjuhë të re.



Njihu me dikë në klasën ose lagjen tënde të banimit të cilin nuk e njeh.



Misionarët i tregojnë talentet e tyre! Disa luajnë në piano në kishë, mësojnë shkrime të shenjta për t'i treguar ose përdorin talente të tjera për të bekuar të tjerët.



Misionarët u japin mësim të tjerëve rreth Jezu Krishtit.



Tregoji një shoku apo shoqeje ose pjesëtari të familjes diçka që mësove rreth Jezusit në Fillore.



Misionarët luten për të tjerët.



Mendo për dy ose tre njerëz që i njeh, dhe lutu për ta. Kërkoji Atit Qiellor t'i bekojë ata.



ILUSTRIMET NGA SAMMIE FRANCIS